REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA
ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT / TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKI
Nr/Br. 94 / 2013
Datë/Datum. 24.03.21
PRISHTINË - PRIŠTINA

Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo

ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT
TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKE
PROCUREMENT REVIEW BODY

PSH. nr. 94/2013

PANELI SHQYRTUES I PROKURIMIT, i emëruar nga kryetari në bazë të nenit 105 dhe nenit 106 të Ligjit për Prokurim Publik të Kosovës nr. 04/L-042, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 04/L-237, Ligjin 05/ L-068, dhe Ligjin 05/ L-092, në përbërje prej: z. Blerim Dina - Kryetar, z. Nuhi Paçarizi-Referues, z. Goran Milenković-Anëtar, duke vendosur sipas Aktgjykimit të Gjykatës së Themelore, Departamenti për Çështje Administrative, A.Nr. 3151/2019 të dt: 09.03.2021, ku është aprovuar kërkesëpadia e paditësit " N.TSH. E-Connect" me Seli në Prishtinë, ndërsa është anuluar konkluzioni i Organit Shqyrtues të Prokurimit me nr. 94/13, i dt: 23.04.2013 lidhur me aktivitetin e prokurimit, me titull: "Modernizmi i sigurisë fizike ne dhomat e serverëve me numër te prokurimit 2014/12/921/111, i iniciuar nga autoriteti kontraktues Policia e Kosovës me dt: 23.03.2021, merr këtë vendim:

V E N D I M

I. **Refuzohet ,** ankesa e OE N.T.SH E-Connect" me Seli në Prishtinë, lidhur me aktivitetin e prokurimit, me titull: "Modernizmi i sigurisë fizike ne dhomat e serverëve me numër te prokurimit 2014/12/921/111, i iniciuar nga autoriteti kontraktues Policia e Kosovës .

II. **Vërtetohet** vendimi i OSHP-së,/Konkluzioni PSH. Nr.94, i dt.23.04.2013, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: "Modernizmi i sigurisë fizike ne dhomat e serverëve me numër te prokurimit 2014/12/921/111, i iniciuar nga autoriteti kontraktues Policia e Kosovës

III. **Zbatohet** vendimi i Gjykatës Themelore-Departamenti për Çështje Administrative-Prishtinë me A.Nr. 3151/2019 të dt: 09.03.2021.

ARSYETIM

Me datën 09.03.2021, Organi Shqyrtues i Prokurimit, ka pranuar aktgjykimin e Gjykatës Themelore departamenti për Çështje Administrative, A nr. 3151/2019, me te cilin aktgjykim është aprovuar kërkesë

padia e OE ankues dhe është obliguar OSHP qe te veproj nga pikëpamja juridike e kësaj gjykate si dhe nga vërejtjet e dhëna lidhur me zhvillimin e procedurës.

Organi Shqyrtues i Prokurimit, gjegjësisht Paneli Shqyrtues më datën. 23.04.2013,, me nr. 94/13, nxjerr Konkluzion dhe refuzon shqyrtimin e ankesës se OE N.T.SH E-Connect" me Seli në Prishtinë, me arsyetimin se aktiviteti i prokurimit ne fjale është tani me si "Res Judicata", sepse me datën 27.02.2013, paneli shqyrtues ka marr vendim meritor për aktivitetin e prokurimit ne fjalë.

Gjykata Themelore në Prishtinë – Departamenti për çështje Administrative, më datës 09.03.2021 nxjerr Aktgjykimin me nr. A.nr.3151/2019 dhe aprovon si të bazuar kërkesë padinë e paditëses N.T.SH. E-Connect" me Seli në Prishtine, dhe konkluzionin e datës 23.04.2013 me nr.94/13 e anulon përderisa çështjen e kthen në rishqyrtim tek i padituri (OSHP) për ri vendosje.

Arsyetimi kryesorë i Aktgjykimit të lartë përmendur thirret në atë se konkluzioni është nxjerre në kundërshtim me Ligjin për procedure Administrative, përkatësisht ne kundërshtim me nenin 136. Përveç saj aktgjykimi thirret ne atë se OSHP, ka qenë i detyruar që te vendos me Vendimin lidhur me ankesën dhe jo me konkluzion, pasi që sipas nenit 97,të Konfliktet Administrative LKA-së me konkluzion vendos lidhur me drejtimin e procedurës dhe për çështje dytësore. Gjithashtu gjykata konstaton se konkluzioni i atakauar është marr ne kundërshtim edhe me nenin 115 të LPP-së.

Në seancën e shqyrtimit kryesor të datës: 23.03.2021, e cila është mbajtur pa prezencën e palëve konform nenit 26 paragrafi 1 të Rregullores së Punës së Organit Shqyrtues të Prokurimit nr. 83/20 të dt:03.03.2020, ku kanë qenë prezent anëtarët e panelit shqyrtues, u shqyrtuan shkresat e lëndës duke e bërë kontrollimin dhe analizimin e dokumentacionit për procedurën e prokurimit i cili përbëhet nga: aktgjykimi A.nr.3151/2019 dt;09.03.2021, vendimi/konkluzion PSH. Nr.94/2013, dt.23.04.2013 .

Paneli shqyrtues ne bazë të konkluzion nr.94/14 të dt;23.04.2013 ka refuzuar shqyrtimin e ankesës se OE ankues me arsyetimin se tani me çështja ne fjale ishte çështje e gjykuar sepse OE ankues ishte i pa përgjegjshëm për aktivitetin prokurimit ne fjale dhe i njëjti operator ekomomik nuk është me palë me interes ne ketë aktivitet te prokurimit ashtu siç parashihet me nenin 4 paragrafi 26 të LPP-së gjithashtu tani (mbi shtate vite) ka përfunduar ky aktivitet i prokurimit.

Paneli shqyrtues konform nenit 117 të LPP-së vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi dhe zbatojë Aktgjykimin e dt: 09.03.2021 A. Nr. 3151/2019, të Gjykatës Themelore-Departamentit për Çështje Administrative me të cilin Aktgjykim është aprovuar kërkesëpadia e paditësit dhe çështja është kthyer në rishqyrtim dhe rivendosje tek e paditura OSHP-ja.

KËSHILLË JURIDIKE:

Kundër këtij vendimi nuk është e lejuar ankesa, por pala pakënaqur me kërkesëpadi mund t'i drejtohet Gjykatës themelore-Departamentit për çështje Administrative në afat prej 30 ditësh nga data e pranimit të këtij vendimi.

Kryesuesi i Panelit Shqyrtues

Blerim [illegible]

Vendimi t'i dorëzohet:

1x1 AK – Policia e Kosovës

1x1 OE – N.T.SH E-Connect" me Seli në Prishtinë

1x1 Arkivës së OSHP-së

1x1 Për publikim në Web- faqe të OSHP-së.